



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.196/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hajriz Hoti-kryesues, Bujar Muzaqi dhe Violeta Husaj Rugova-anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër kandidates për Kuvend të Komunës së Gjakovës Eranda Kumnova Baçi, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 13.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, ZL.Anr.196/2025, e datës 11.10.2025, e paraqitur kundër kandidates për Kuvend të Komunës së Gjakovës, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Eranda Kumnova Baçi, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Zgjedhje Lokale në Republikën e Kosovës, të mbajtura me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 11.10.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZL.Anr.196/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se me datë 10.10.2025, kandidatja për Asamblenë Komunale të Gjakovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, znj. Eranda Kumnova Baçi, e cila aktualisht mban pozitën Drejtoreshë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në Komunën e Gjakovës, ka publikuar në rrjetin social Facebook një video me përmbajtje të qartë elektorale, e realizuar brenda hapësirave të një shkolle publike. Në këtë video, kandidatja përdor institucionin arsimor publik dhe autoritetin e saj zyrtar për të bërë premtime zgjedhore, duke shfrytëzuar burimet e administratës publike për fushatë. Ky veprim përbën shkelje të nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, i cili ndalon përdorimin e zyrës, pasurisë ose resurseve publike për qëllime të fushatës zgjedhore, si dhe shkelje të nenit 6 dhe nenit 7 të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, që ndalojnë shfrytëzimin e burimeve të institucioneve publike dhe hapësirave të shkollave për aktivitete të fushatës. Përdorimi i shkollave publike për qëllime elektorale përbën shkelje të barazisë në garë, si dhe komprometon integritetin e procesit zgjedhor, duke krijuar perceptim të rremë se institucionet publike mund të vihen në funksion të një subjekti politik të caktuar. Vlen të theksohet se kjo

është herë e dytë që e njëjta kandidate përdor resurse të shkollave publike për qëllime të fushatës, çka e bën këtë rast përsëritje të qëllimshme të shkeljes ligjore. Për këto arsye, kërkojmë nga PZAP që, të konstatojë shkeljen e bërë nga kandidatja znj. Eranda Kumnova Baçi dhe të urdhërojë fshirjen e menjëhershme të materialit të paligjshëm, si dhe të ndërmarrë masat e parapara ligjore. Si provë ka bashkangjitur një video në CD.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, thekson se pretendimet e paraqitura nga LVV se subjekti politik AAK, ka kryer "shkelje të qarta ligjore, më konkretisht të dispozitës së Nenit 36 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme ("LZP") dhe Nenit 6 dhe 7, të Rregullores Zgjedhore Nr. 07/2024, duke publikuar një video "të realizuar brenda një hapësire të një shkolle publike", nuk qëndrojnë sepse përmes videos të bashkangjitur si provë mund të konstatohet vetëm një rrethanë faktike se: Znj. Baçi ka publikuar një video brenda një hapësire të brendshme, mirëpo nuk dihet se në cilin vend. Në këtë drejtim, duhet theksuar se barrën e provës për të dëshmuar se hapësira e paraqitur në video i përket një shkolle publike e ka pasur vetë ankuesja. Megjithatë, në rastin konkret, ankuesja nuk ka ofruar asnjë provë që do të mund të identifikonte me siguri se ambienti në fjalë është pjesë e një institucioni arsimor publik. Ajo nuk ka arritur të vërtetojë se në cilën shkollë publike, sipas pretendimit të saj, është realizuar videoja në fjalë, apo nëse me të vërtetë është kryer videoja brenda një shkolle apo ndonjë hapësire të brendshme të ndonjë qendre trajnimit apo diku tjetër. Pamjet e dorëzuara si prova nuk përmbajnë asnjë element dallues si emër të institucionit simbole shtetërore apo shenja identifikuese që do ta vërtetonin me siguri se bëhet fjalë për një shkollë publike. Më tej, duhet theksuar se PZAP, ka vendosur praktikë të qartë se refuzohen të gjitha ankesat e subjekteve të cilat nuk mund të vërtetojnë me siguri lokacionin se ku është kryer shkelje me prova konkrete. Këtë e vërteton edhe Vendimi ZL.A.nr. 91/2025, i datës 03.10.2025, në të cilin paneli ka refuzuar ankesën e ankueses për faktin se ajo nuk ka arritur të vërtetojë me siguri lokacionin ku pretendohet se është kryer shkelja, njësoj si në rastin konkret, ku nga provat e paraqitura nuk mund të përcaktohet me saktësi vendi ku është realizuar videoja, përkatësisht në cilën shkollë dhe a është bërë videoja me të vërtetë brenda një shkolle. Gjithashtu, subjekti politik AAK thekson se në rastin konkret, në videon e bashkangjitur si provë nga ana e subjektit politik "LVV", në asnjë pjesë të saj nuk është specifikuar data e publikimit të videos. Për pasojë, në mungesë të një prove që përcakton kohën e saktë të kryerjes së shkeljes së pretenduar, ankuesja nuk ka mundur të dëshmojë se ankesa e saj është dorëzuar brenda afatit ligjor të përcaktuar. Andaj, në mungesë të besueshmërisë juridike dhe arsyeshmerisë së ankesave të tyre, i propozojmë PZAP, që të merr vendimin përmes së cilit, ankesën ZL.A.nr.196/2025 ta refuzojë si të pa bazuar, apo njëjtën ta hudhë poshtë si të pasafatshme.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën, përgjigjen në ankesë dhe provat e bashkangjitura, vëren se ankesa e ankuesit është e pazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik AAK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), janë të pa qëndrueshme, dhe të pazuar, dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të nenit 36 i Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ku përcaktohet se *"1. Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të*

nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje.” Po ashtu, të njëjtat nuk përbëjnë shkelje të nenit 6, të Rregullores Zgjedhore Nr.07/2024, për Fushatën Zgjedhjeve, Monitorimin e Fushatës së Zgjedhjeve dhe Deklarimin Financiar, i cili nen normon veprimet e ndaluara nga nëpunësi publik, i cili përcakton se “1. Nëpunësit civil që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, për qëllime të fushatës së zgjedhjeve, ju ndalohen veprimet në vijim, siç përcaktohet me nenin 36 të LZP: 1.1. Përdorimi i zyrës dhe çfarëdo infrastrukture apo pasurie të saj, me qëllim të përfitimit të votës; 1.2. përdorimi i burimeve që përfshinë burime të institucionit të administratës publike të nivelit qendror, lokal ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim apo të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale.”

Paneli vëren se parashtruesi i ankesës i referohet shkeljes së dispozitave ligjore të lartcekur, konkretisht nenit 36 i Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës i cili ndalon përdorimin e zyrës, pasurisë ose resurseve publike për qëllime të fushatës zgjedhore, mirëpo paneli në bazë të shkresave të bashkangjitura ankesës, përkatësisht videos, nuk vërteton faktin në mënyrë të qartë dhe bindëse se kandidatja për Asamblenë Komunale të Gjakovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, znj. Eranda Kumnova Baçi, e cila mban pozitën Drejtoreshë për Arsim, Shkencë dhe Teknologji në Komunën e Gjakovës, videon e publikuar e ka bërë në një shkollë publike, me saktësisht nuk ka prova të cilat e konstatojnë në mënyrë të qartë dhe bindëse se e njëjta ka shfrytëzuar ambientin e institucionit arsimor publik për të bërë fushatën zgjedhore. Ngase Në videon e bashkangjitur si provë nuk përcaktohet se në ambientin e cilës shkollë publike është zhvilluar ngjarja, emri i shkollës publike, vendi-rruga se ku gjendet e njëjta shkollë etj, përkatësisht nuk shihet ndonjë shenjë identifikuese se cila shkollë është dhe se e njëjta është shkollë publike, me të cilin veprim do të provohet se e njëjta ka bërë shkeljen të dispozitave të sipërcituara ligjore.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nuk ka prova që e vërtetojnë se veprimet e përshkruara në ankesë nga parashtruesi i ankesës paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura, dhe të njëjtën e refuzoi si të papabazuar.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
ZL.Anr.196/2025 datë 13.10.2025

Kryesuesi i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 Për zgjedhjet e përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykata Supreme të Kosovë, brenda 48 orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.